

FJALA E DEPUTETES FLUTURA AÇKA

E ENJTE DATA 2 MARS 2023

Është edhe kohë dreke tani dhe janë zënë në gojë fjalët “byrekë”, “petulla”, “petanik” e gjithfarë metaforash me shqiptarët; m’i lini mua. Gjëja më trishtuese sot është lajmi që Kryeministri s’do të na begenisë më në parlament. Ky m’u duk lajmi më i keq, për faktin se kam përshtypjen që ai ka atë sindromën e elektronit të Edinberg-ut, kur thotë: “Që ta njohësh atë elektron, duhet patjetër që ta këqyrin të tjerët”, kështu që mua më dhimbset Kryeministri. Gjithsesi, meqenëse nuk vjen zoti Kryeministër, këshillojeni që të shkarkojë në një nga platformat e muzikës një pjesë të njohur muzikore, të quajtur “Heshtja”, nuk e mbaj mend autorin, por e di që ekziston diku, dhe është vetëm disa minuta heshtje; ta dëgjojë herë pas here, sepse do t’i duhet tani e tutje, meqenëse s’do të na begenisë më, madje po ta dija autorin, do ta këshilloja që ta titullonte “Eremizmi i Edi Ramës”. Të kthehem te çështja. Zonja Kryetare nuk është këtu, por do të doja ta falënderoja për iniciativën e marrë, për zinë për tri gratë që u vranë barbarisht dje! Është një gjë e mrekullueshme, vetëm se mungoi diçka: nuk u tha që ato gra i ka vranë shteti; i kemi vranë ne këtu. Këtu kanë ardhur iniciativa dhe amendamente në ndihmë të grave, buxhete të caktuara për gratë, por një pjesë të tyre i keni kaluar pa i votuar, vetëm pse i ka sjellë opozita. Këto ditë do të vijë një rezolutë për mbrojtjen e grave dhe shpresoj që, me gjithë këtë përdëllim të madh që bëtë për këto 3 zonja të nderuara shqiptare, të cilat nuk kanë mbrojtje, të vetmen mbrojtje që kanë është ligji, por as ligji nuk funksionon, do ta votoni rezolutën, të paktën atëherë do të jetë e vërtetë kjo zi. Ajo që u pa sot ishte sjellja po e njëjtë e Kryeministrit shqiptar. Nuk e di, kamerat nuk e kapën, se i kontrollojnë, por në nisje të seancës, disa ministre, vajza të nderuara, mungonin. Kryeministri i fyeu ato, por kamerat nuk e kapën atë që u tha Kryeministri. Unë e marr me mend se çfarë u ka thënë zonjës Muzhaqi, zonjës Bilali, zonjës Manastirliu, zonjës Xhaçka dhe zonjës Balluku, të cilat sot kanë qenë viktimat të dhunës së tij verbale. Si është e mundur... (Ndërhyrje nga salla pa mikrofon) Ju lutem, a ka mundësi të mbaroj unë, pastaj të flisni ju? Si është e mundur? Çfarë shembulli është ky, kjo gjuhë, për ata kriminelët atje jashtë parlamentit? Sigurisht, do ta mohoni, nuk më intereson fare, se e kanë dëgjuar 140 veta, nuk ka nevojë fare ta thoni.

Në fakt, zoti Kryeministër deri tani, dhe shumë mirë që nuk do të vijë më, është sjellë vetëm si kafsha Alfa në këtë zoo, në këtë “kopsht zoologjik”, siç e ka quajtur parlamentin. Atë bëri edhe sot. Ndonjëherë zbrit i shkreti, bëhet edhe si qengj, por gjithë kohën ka bërën Alfa-n. Veç ai e di se nga e merr këtë shqisë, ai e di se nga i vjen kjo gjë. Po, kështu është sjellë gjithmonë, si ujk i tërbuar këtu, madje po ju sjell në vëmendje edhe fjalorin që përdori sot: “baltë, katran, hi, llum, baltovinë, hale”. Po, këtë të fundit e ka përdorur sot në parlament Kryeministri shqiptar. Kushedi çfarë problemesh patologjike ka, ai e di, por kjo është gorga, ky është fjalori i këtij parlamenti dhe pastaj ne ankohe mi për kriminelët përjashta. A ka gjë më kriminale sesa kjo gjuhë që përdoret në këtë parlament? Në fakt, çfarë bëjmë ne, kolegë, edhe të djathtë, edhe të majtë? Ne, të djathtët, ç’bëmë ne? Gjithë ditën veçse kemi bërë: “Mbreti është lakuriq”. Lakuriq është, çfarë t’i bëjmë? Nuk ka më debat për këtë gjë, apo jo? Ndërkohë, ju, kolegë të mazhorancës, çfarë bëni? I përkuleni. Ka ikur ai, ka lënë kësulën këtu, tamam si tek ajo vepra e Shilerit “Vilhelm Teli” dhe ju veçse i përkuleni kësulës dhe vazhdoni të njëjtin fjalor, të njëjtin refren, pastaj thoni: “Turp ky, turp ai!” A ka gjë më turp sesa ky? Nuk e di, unë nuk shoh asgjë tjetër veç përkuljes ndaj kësulës që ai ka lënë këtu, ndaj hijeve që ai ka lënë këtu. Në fakt, nuk e di kë sulmojmë ne dhe kë mbron ju. Njeriu që e ka sharë Shqipërinë në gjuhë të huaj, deri tani ka bërë kundër nesh, qoftë edhe kundër meje personalisht. Ka futur njerëz në vitin 2014 në dy gazeta shqiptare, në faqe të parë jam sharë nga kjo qeveri, pikërisht demok se unë e paskam sharë

Shqipërinë në gjuhë të huaj, kur kam thënë një të vërtetë se është kanabizuar dhe se çfarë nuk po ndodh me këtë Shqipëri. Tani është radha e tij të japë llogari përse Shqipërinë e ka sharë në gjuhë të huaj dhe jo pak, por në pjesën më të madhe të medieve më të rëndësishme, nëpër gazetatat më të rëndësishme në botë, te gazetarët më autoritarë në botë, që kanë shkruar për të. Ai përmendet personalisht. Po të isha unë në vendin e tij, do të kisha ikur me nder, duke thënë: “Ndjesë, po iki dhe po lë drejtësinë. Pastaj, nëse jam me të drejtën, jam me të drejtën. Nëse nuk jam, shkoj atje ku duhet të shkoj”. Sepse, zotërinj të nderuar, qeverisja, para se të jetë një ngrehinë politike, është ngrehinë morale dhe vendi i Kryeministrit, pozita e tij, para se të jetë politike, është një pozitë morale, gjë e cila sot, siç u pa dhe po shihet, nuk po ndodh as në këtë qeverisje, as në këtë parlament. Në fakt, jemi edhe ne pjesë e fajit, sepse këtu jemi bashkëdëshmitarë. Ky është opinionimi im, por besoj edhe i shumë njerëzve brenda dhe jashtë këtij parlamenti. Kryeministri shqiptar që thotë non-grata, shqyhet e bëhet, është varieteti më i keq i të gjithë pasardhësve të tij. Jo vetëm që nuk ka ndonjë shenjë prej dinjitarit, por as prej shtetari normal nuk ka; respektin ndaj Kushtetutës nuk e ka! Pse do të thoni ju? Ja, jua shpjegoj unë. Sepse Kryeministri mbath atje aty ku shkohet me këpucë, se Kryeministri ynë vesh brekushe atje ku hyhet me redingotë, se Kryeministri ynë mbath “Yamamoto”, atje ku njerëzit vdesin me arna! Nuk e keni parë ju, por e kam parë unë, jam dëshmitare e kësaj kohe.

Në seancën e fundit parlamentare, atëherë kur ai ishte me zë e figurë këtu, po flas për në dhjetor (se sot erdhi me gjysmë zëri, me gjysmë figure, siç e patë), më është përgjigjur personalisht... (Diskutime në sallë) Ju lutem, a ka mundësi të heshtni pak? ... se “kush është kriminel, kush është hajdut, kush është mafioz, zonja Aça, është subjekt i ligjit, subjekt i drejtësisë”. Kam përshtypjen dhe bindjen se çështja “McGonigal”, siç u tha edhe nga parafolësit e mi, i përmbledh të gjitha këto e detyrimisht edhe Kryeministri shqiptar është i detyruar t’i përgjigjet drejtësisë, të jetë subjekt i ligjit dhe i drejtësisë, nëse ka një minimum nder! Atëherë, meqenëse nuk munda t’i kthej dot përgjigje; sot kisha menduar një fjalë tjetër për t’ia treguar nëse është ose jo mafioz, kriminel e gjëra të tjera të kësaj si dore, po i them që në sytë e mi është kriminel, sepse ka rrëzuar në mënyrë kriminale Teatrin, ka vjedhur në mënyrë kriminale Butrintin, ka ndihmuar të vidhen paratë për të ruajtur të dhënat e shqiptarëve, që janë hakëruar, si dhe e ka mbushur Shqipërinë me patronazhistë, me aktivistë! Në 25-ën ngrijini pak më lart, bëjini aksionistë! Po, zoti Kryeministër nuk është mafioz, por sillet si i tillë me gazetarët! Nuk është mafioz, por sillet si i tillë me shoqërinë civile! Vetë e mbani mend si thoshte: “Ku është shoqëria civile, t’i hedh lule te varri që hap”? Në orën 5 e ka shoqëria civile protestën. Shkoni, zotëri, shkoni në protestë! Nuk është mafioz Kryeministri ynë, por sillet si i tillë me sindikatat. Mos harroni intervistën që dha në Itali, ku u bënte thirrje bizneseve italiane: “Ejani në Shqipëri, se nuk ka sindikata, nuk proteston kush. E keni lëmë”. Sigurisht, Kryeministri nuk është mafioz, por sillet si i tillë me bizneset. E keni këtu një nga kolegët tanë, i cili është objekt i vazhdueshëm i sulmeve qeveritare, dhe të tjera biznese, por nuk po i përmend tani se është radhë shumë e gjatë. Kryeministri ynë nuk është mafioz, por sillet me fatet e shqiptarëve në mënyrë mafioze. Mjaftojnë zgjedhjet e vitit 2021, ku vetëm në Elbasan keni vjedhur 48 mijë vota. Ç’është e vërteta, në Elbasan keni dalë me humbje. E di që keni dalë me humbje... (Bie gongu.) E fundit dhe mbarova, por edhe mund të vazhdoj, sa të doni ju vazhdoj. Zoti Kryeministër, në fakt, ty të dehu karma jote, siç thua edhe vetë “Karma është rruspi” dhe të mori përpara rruspija jote. Ama, të ka mbetur vetëm një gjë, të pushtosh Shkodrën me të njëjtën ethe si Sulltan Mehmeti II Kostandinopojën 5 shekuj e ca më parë. Por, ju mund ta fitoni... (Bie gongu.) Mbarova, jam në sekondat e fundit! ...Shkodrën, vetëm nëse Shkodra shitet, vetëm nëse Shkodra blihet ose të dyja bashkë, shitet dhe blihet, sepse ju nuk e fitoni dot Shkodrën kurrë mbi këtë dhë, por i keni përgatitur skalionet dhe do të lini gjurmë kudo, kjo është e sigurt. Ama, përpara se të mbërrini te Shkodra, unë do t’ju kujtoj fjalën e Vasili Grosmanit në kohën e etheve të Stalingradit, kur thoshte: “Nëse gjermanët hyjnë në Stalingrad, Hitleri do të mësojë dy të vërteta, por nuk do të shijojë asnjërën, pasi do të jetë fundi i tij”.